



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 218

Tiranë – E enjte, 17 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 978, datë 4.12.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 52, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2015”, të ndryshuar..... 14379
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 983, datë 9.12.2015	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për bashkëpunimin ekonomiko-teknik..... 14379
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 984, datë 9.12.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik te Ministria e Zhvillimit Urban, për Entin Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi, të disa pronave të paluajtshme shtetërore në godinën nr. 57, në bulevardin “Zogu i Parë”, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 450, datë 16.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik”, të ndryshuar..... 14380
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 985, datë 9.12.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 14390
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 986, datë 9.12.2015	Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, të një objekti dhe të truallit funksional brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, me vendndodhje në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë..... 14390
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 988, datë 9.12.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 430, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Universitetit të Tiranës”..... 14392

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 989, datë 9.12.2015	Për organizimin, funksionimin, kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH).....	14392
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 990, datë 9.12.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 424, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, të ndryshuar.....	14393
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 991, datë 9.12.2015	Për përcaktimin e rregullave për miratimin e investimeve dhe dhënien e shpërblimeve për administratën tatimore qendrore.....	14394
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 993, datë 9.12.2015	Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqipëri), në kuadër të anëtarësimit në organizimin ndërkombëtar EITI-International.....	14396
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 994, datë 9.12.2015	Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi	14397
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 995, datë 9.12.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim komunave Buçimas, Çërravë dhe Udenisht dhe për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 4.4.2012, nr. 417, datë 8.6.2011 dhe nr. 534, datë 1.5.2008.....	14402
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 996, datë 9.12.2015	Për kriteret e bashkëfinancimit të projekteve apo shërbimeve të kujdesit paliativ, në rastin e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe organizatave jofitimprurëse.....	14408
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 998, datë 9.12.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës nr. 5, loti 2 dhe 3, Sarandë”.....	14409
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 999, datë 9.12.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i shëtitores kryesore anës detit, Himarë”.....	14410
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1000, datë 9.12.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës nga Muzeu Historik - Spitali, Vlorë”.....	14412



VENDIM

Nr. 978, datë 4.12.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 52, DATË 21.1.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË
DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS
SË PËRFITIMIT NGA FONDI I
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2015”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të vendimit nr. 52, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, vlera “154 700 000 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë e shtatëqind mijë) lekë”, ndryshohet dhe zëvendësohet me “112 049 122 (njëqind e dymbëdhjetë milionë e dyzet e nëntë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë”.

2. Vlera prej 42 650 878 (dyzet e dy milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh, e papërdorur si bashkëfinancim për projektin IPA 2011, të përdoret për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe agropërpunimit, në përputhje me pikën 2, të vendimit nr. 52, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 983, datë 9.12.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS,
PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIKO-
TEKNIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për bashkëpunimin ekonomik-teknik, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

**PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIKO-
TEKNIK NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Popullore të Kinës, për të zhvilluar më tej marrëdhëniet e bashkëpunimit miqësor dhe të bashkëpunimit ekonomik-teknik midis dy vendeve, bien dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

Sipas nevojave të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeveria e Republikës Popullore të Kinës i jep një ndihmë falas Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, me vlerë prej 10 (dhjetë) milionë shyuam RMB.

Neni 2

Ndihma e sipërpërmendur do të përdoret për objekte që do të përcaktohen bashkërisht nga



qeveritë e të dyja vendeve. Çështjet konkrete do të caktohen në marrëveshje të tjera që do të lidhen mes palëve.

Neni 3

Modalitetet teknike financiare që kanë lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të përcaktohen nga Banka e Zhvillimit të Kinës dhe nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën kur palët njoftojnë njëra-tjetrën mbi përfundimin e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve dhe do të jetë e vlefshme derisa të dyja qeveritë të përmbushin të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë marrëveshje.

Neni 5

Kjo marrëveshje nënshkruhet në Tiranë, në datën 23.1.2014, në dy kopje origjinale, ku secila palë mban nga një kopje. Çdo kopje nënshkruhet në gjuhën shqipe, në gjuhën kineze dhe angleze dhe secili version me përmbajtje të njëjtë.

VENDIM

Nr. 984, datë 9.12.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK TE MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE ME QËLLIM PRIVATIZIMI, TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË GODINËN NR. 57, NË BULEVARDIN “ZOGU I PARË”, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 450, DATË 16.6.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11, 13, 15, shkronja “c” e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme

të shtetit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomantik te Ministria e Zhvillimit Urban, për Entin Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi, të disa pronave të paluajtshme shtetërore në godinën nr. 57, në bulevardin “Zogu i Parë”, me numër pasurie 6/217-1+1 dhe 6/217-2+21, në zonën kadastrale nr. 8350, Tiranë, sipas listës nr. 1 dhe hartës treguese të pronës, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pronat e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 450, datë 16.6.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të lidhë kontratat e privatizimit me personat e përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas kushteve të privatizimit, të përcaktuara në udhëzimin nr. 17, datë 17.10.2012, të ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, “Për procedurat e shitjes së banesave pjesë përbërëse e objekteve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Zhvillimit Urban, Enti Kombëtar i Banesave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA NR. 1

1. Luzhiana Dine Abazi – apartamenti me numër pasurie 6/217-1+1

2. Denada Vergjil Merko – apartamenti me numër pasurie 6/217-2+21






Subject: 1

Sip. Ag. 241 = 77.8 m²
Sip. Ag. 141 = 93.6 m²
Sip. Kufar-Shehale = 28.2 m²
Sip. Totale = 169.6 m²


class


Sep. Ap. 2+1 = 77.8 m²
 Sep. Ap. 1+1 = 59.6 m²
 Sep. Kabin. Stühle = 28.2 m²
 Sep. Totale = 165.6 m²

PER PRETORIJE I. SHERHMIT TE TRUITE DIPLOMATIK
KONFERENZ : INGELAND THEODOR

DREYFUS
SHIPING SPAIN

COGNOME	PAJANI OTTILIO
INTELLIGIBILITA'	PLAUSIBILE, C. RANCI IN SERIE
PROFUMORE	DETERMINATO E SOSTANZIATO SOSPENSIONE
GRUPPI FUMI	NO. LA 30005
GRUPPI "C" - "C" - "C" - "C"	NO. 0000
GRUPPI "C" - "C" - "C" - "C"	72 - 0000
GRUPPI "C" - "C" - "C" - "C"	K - 0000
GRUPPI "C" - "C" - "C" - "C"	Primo 1000000







REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME TIRANE
Adresa: Rr. "Jordan Mita" Tirane.

VERTETIM
NGA DOKUMENTET HIPOTEKOR

Vertetohet se ne Regjistrin Hipotekor me Nr. 164 Date 06/07/2007 figuron e regjistruar ne pronesi te:

EMRI ATESL MBIEMRI PJESA
DRETTORIA E SHERBIMIT TE TROPIT DIPLOMATIK

Pasuria me Nr. 6/217+2-24 ndodhur ne Zonen Kadastrale 8350 me Sip 92 m²
ne adresen: RR NR. 24, NDOHUR NE RRETH ME NDE SIP TOTALE
PREJ 92 M², KATI I SHTATE, I SHKALLE 36 NYTE, NGA E
CILA 77.8 M² ESHT E SHRYTEZUESME, KURSE 14.2 M² ESHT E
SIP E SHKALLEVE

Kufizimet e Pasurise jane:

X L
X P

Origjina e regjistrimit te pasurise se paluajtshme:

Nr. Hip. —, dt. —/—/— Nr. Hip. —, dt. —/—/—

Nr. Hip. —, dt. —/—/— Nr. Hip. —, dt. —/—/—

Barre mbi pasurine NUK KA

Komente nga regjistruesi:

Ky vertetim eshte i vlefshem i shoqeruar me Harten Treguese Provizore

Ky formular miratohet per vertetimin e pronesise deni
ne perfundimin e Regjistrimit Fillestar, sipas Ligjit
Nr 7843, date 13/07/1994

Vertetimi i pronesise leshohet sipas kerkeses
Nr. 3574, dt. 07/04/2007
paraqitur prane ZRPP Tirane

Date 06.07.2007

REGJISTRUES

FADIL KALOSHI



HARTA TREGUESE E PASURISË

**ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
TIRANË**

**REGJISTRUESI
FADIL KALOSHI**

Futur/Firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE 6350 NR I PASURISË 6/217 Vol. 22

INDEKSI I HARTËS TR-11-11 SHKALLA 1:500

ADRESA E PASURISË: Rrethi TIRANË

O/F TIRANË Rr/K DUK. 2. PARRE

P/G Sh K Ap

B. KUFIZIMI

V 6/216

P 6/216

DATA 06/07/2007 OI A. DUKO

C. PRONARI

DREJT. SHERB.

DIPLOMATIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë
Adresa: Rr: "Jordan Misja"

VERTETIM

NGA DOKUMENTAT HIPOTEKORE

Verifikohet se ne Regjistri in Hipotekor me Nr. 153, Dat: 16/07/2007 figuron
regjistruar ne pronesi te:

MRI ATE LA MCHMR PJESA

DREKTORIA E SHERBIMIT TE TRUPIT DIPLOMATIK

Pasuria me Nr. 647⁴⁻¹ e ndodhur ne Zonen Kadstrale 8350 me Sip. 92 m² n adresen: Apartamenti NR. 1, ndodhur ne Ratin e Krates te
ndodhur ne pall. 57, me me sip. totale prej 92 m², nga e
cila 77.8 m² baste sip. e aflytshvencime, baste prej 14.2 m² baste
sip. e dhallave

Kufizimet e Pasurisë janë :

Originea e registrată te pasurise se palvaftshme :

N: H ₂ P	1	00	1	1	1	N: H ₂ P	1	00	1	1	1
N: H ₂ P	1	00	1	1	1	N: H ₂ P	1	00	1	1	1

Barre mbi pasurine NUK KIA

Komente nga registruesi

Ky vertetim është i vlefshëm i shogruar me Harten Treguese Provincore

Ky formularmiratohet per vatezhimin e pronesise deri ne perfundimin e Regjistrimit Fillestar sipas Ligjit Nr. 7843, date 13/07/1994

Vartatuzim i pronosisë lëshohet sipas kërkesës
Nr. 3574 dt. 02/04/2007
paraqitja pranë ZVRPP Tiranë.

Date 06/01/2007

REGISTRES

FADIL KALOSHI



HARTA TREGUESE E PASURISË

**ZYRA E VENDORË E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
TIRANË**

**REGJISTRUESI
FADIL KALOSHI**

Futje/Futurë

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE 6/214 NR I PASURISË 6/214 Vol. 22 Fc 227

INDEKSI I HARTËS TR-H-11 SHKALLA 1:500

ADRESA E PASURISË: Rrethi TIRANË

C/F FIRANE Pr/V BUC. 2-PARELL

P/657 Sh 1 K 3 Ap 1

B. KUFIZIMET

V 6/217

L 6/217

P 6/217

C. PRONARI

DREJT. SHERB.

DIPLOMATIC

DATA 06/07/2008 ORA — A. DURO



VENDIM

Nr. 985, datë 9.12.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, regjistrohet individ i renditur në shkronjën “a”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”;

1. EMRAH; ERDOGAN.

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Faqe | 14390

VENDIM

Nr. 986, datë 9.12.2015

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES, MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRIËS, PËR SHËRBIMIN GJEOLGJIK SHQIPTAR, TË NJË OBJEKTI DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 6, ME EMËRTIM “INSTITUTI GJEOGRAFIK I USHTRISË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “MYSLYM KETA”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, për një periudhë 35-vjeçare, të objektit nr. 5 dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 747 (shtatëqind e dyzet e shtatë) m², brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim “Instituti Gjeografik i Ushtrisë”, me vendndodhje në rrugën “Myslym Keta”, Tiranë, për t’u përdorur në funksion të veprimtarisë së administratës së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e objektit dhe të truallit funksional, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënie në përdorim të përkohshëm të objektit dhe të truallit funksional, sipas pikës 1, të këtij vendimi, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.


4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Energjisë dhe Industrisë, drejtori i Përgjithshëm i



Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama





VENDIM
Nr. 988, datë 9.12.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 430, DATË 2.7.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI UNIVERSITETIT TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 117, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve

të Brendshme dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr. 430, datë 2.7.2014, të Këshillit të Ministrave, shtohet prona me numër rendor 19 (nëntëmbëdhjetë), sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Punëve të Brendshme, Universiteti i Tiranës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

INVENTARI I PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE TE UNIVERSITETIT TE TIRANES

Institucioni i pushtetit Qendror Ministria e Arsimit dhe Sporteve											
Bashkia e Tiranës											
Fusha e përdorimit të pronës Universiteti i Tiranës											
Nr.	Zona Kadastrale & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurie	Lloji i Prones	Komuna / Bashkia	Emri i Prones Adresa	Sip. Tot. e Prones (m2)	Sip. Godine ne Prone (m2)	Funksion i I prones	Institucioni qe administron pronen	Njesia Perdoruese	Akti normativ i lenies ne administrim
19	8160 TR-S- 14	5/80,93	God. + Truall	B. Tirane	Terenet Sportive	28800	160	Arsim	UT	Rektorati	VKM Nr.834, dt 13.12.2006

VENDIM
Nr. 989, datë 9.12.2015

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, KOHËZGJATJEN E QËNDRIMIT NË DETYRË DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR (KALKSH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH), si organ këshillimor për politikën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, pranë ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ka në përbërje 12 anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të njohura të fushave akademike.

3. Anëtarët e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor emërohen me urdhër nga ministri përgjegjës për arsimin për një periudhë 1-vjeçare, me të drejtë riemërimi pa kufizim dhe shkarkohen prej tij.



4. Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, sipas kërkesave apo propozimeve të ministrit përgjegjës për arsimin, shqyrton dhe këshillon ministrin lidhur me:

a) hartimin e strategjive e të programeve kombëtare për arsimin e lartë e kërkimin shkencor, drejtimit e politikave respektive dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore;

b) fushat parësore dhe programet e kërkimit shkencor e të zhvillimit teknologjik;

c) standardet për hapjen, riorganizimin, pezullimin, mbylljen dhe akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë ose programeve të studimeve;

ç) kriteret për dhënien e titujve dhe gradës shkencore;

d) zhvillimin e politikave të veçanta dhe mënyrat e financimit të tyre;

dh) statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik;

e) çdo çështje tjetër që kërkohet nga ministri përgjegjës për arsimin.

5. Ministri përgjegjës për arsimin, me qëllim realizimin e misionit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor me urdhër mund të ngrejë komisione të përhershme apo të përkohshme me anëtarët e këtij këshilli, për studimin e çështjeve e të problematikave të veçanta.

6. Ministri përgjegjës për arsimin, me qëllim realizimin e misionit të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor me urdhër mund të caktojë nëpunës të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në cilësinë e sekretariatit teknik të KALKSH-it.

7. Kryetari i Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor apo në mungesë një anëtar i caktuar prej tij me urdhër thërret mbledhjet dhe i drejton ato, cakton rendin e ditës, drejton diskutimet, bashkërendon punën, si dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të brendshëm të KALKSH-it.

8. Njoftimi për mbledhjet, rendi i ditës, si dhe çdo ndryshim në datën e kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohen çdo anëtar nga sekretariati i KALKSH-it ose nëpunës të ngarkuar me urdhër të ministrit.

9. Ministri përgjegjës për arsimin miraton me urdhër të tij rregulloren e funksionimit të brendshëm të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.

10. Anëtarët e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor shpërblehen për pjesëmarrje në mbledhjet e këtij Këshilli, sipas akteve nënligjore në fuqi.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 990, datë 9.12.2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 424, DATË 2.6.2010,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
SISTEMIN E AKREDITIMIT,
ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E
INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË
JASHTËM TË CILËSISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 60, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 138 e 142, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë, të miratuar me vendimin nr. 424, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenin 5 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Në shërbim të politikave të arsimit të lartë ministria përgjegjëse për arsimin mund të kërkojë vlerësimin e jashtëm të cilësisë së institucioneve e të programeve të studimit nga agjenci të tjera



vlerësimi, që janë anëtare me të drejta të plota të Rrjetit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ose të Regjistrat Evropian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (EQAR). Vlerësimi i jashtëm dhe konsulenca për kryerjen e këtij vlerësimi nga këto agjenci kryhet me qëllim akreditimin e programit/programeve të studimit apo të institucionit të arsimit të lartë. Vlerësimi i jashtëm nga këto agjenci kryhet në përputhje edhe me standardet e procedurat vendase për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.”

b) Në fund të pikës 1, të nenit 5, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Agjencia e huaj, pjesë e ENQA-s e EQAR-it, kontraktohet drejtpërdrejt nga ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me tarifën e përcaktuara në këtë rregullore për vlerësim të jashtëm të cilësisë së programit/programeve të studimit apo të institucionit/institucioneve të arsimit të lartë dhe konsulencë për kryerjen e këtij vlerësimi.”

2. Në nenin 9/1 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët “... tabelat nr. 1 dhe nr. 2, ...” zëvendësohen me “... tabelat nr. 1.1 dhe tabela nr. 2.1 ...”.

b) Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

“3. Pagesat për konsulencë për agjencitë e huaja të vlerësimit kryhen në bazë të tarifës ditore 700 euro/dita për çdo ekspert të huaj të angazhuar, por jo më shumë sesa 10 ditë pune për çdo ekspert të huaj. Ekspertëve të huaj të angazhuar nga agjencia e huaj e vlerësimit u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.

4. Pagesat për agjencitë e huaja të vlerësimit për akreditimin e programit/programeve të studimit apo të institucionit të arsimit të lartë bëhen mbështetur në pagesat mbi bazë eksperti, sipas pikës 2, të këtij neni, ku agjencia e huaj e vlerësimit mund të ketë shumicën e ekspertëve në grupet e vlerësimit. Ekspertëve të vlerësimit të angazhuar nga agjencia e huaj e vlerësimit u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 991, datë 9.12.2015

PËRPËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR MIRATIMIN E INVESTIMEVE DHE DHËNIEN E SHPËRBLIMEVE PËR ADMINISTRATËN TATIMORE QENDRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 21, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky vendim përcakton rregullat për miratimin e investimeve të administratës tatimore qendrore, të pafinancuara nga buxheti i shtetit, për dhënie të shpërblimeve për punonjësit e hetimit tatimor për kryerjen e shërbimeve me rrezikshmëri të lartë, si dhe për dhënie të shpërblimeve stimuluese për personelin e administratës tatimore qendrore, bazuar në efektivitetin në punë, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 21, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

II. BURIMI DHE MËNYRAT E FINANCIMIT

1. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i lihen deri në 2% të të ardhurave tatimore të mbledhura për t’u përdorur për investime për përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës së mbledhjes të të ardhurave, për shpërblime, bazuar në realizimin e detyrave operacionale të strukturave të hetimit tatimor, si dhe për shpërblime stimuluese të personelit të administratës tatimore qendrore, sipas rregullave të parashikuara në këtë vendim.

2. Ministri i Financave me urdhër miraton çdo vit shumën limit për investimet dhe shumën limit për shpërblimet stimuluese të personelit, mbështetur në tejkalimin e të ardhurave tatimore.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, bazuar në shumën e miratuar, sipas pikës 2, të ndarjes II, të këtij vendimi, miraton detajimin e këtyre shumave për drejtoritë rajonale dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.



III. PROCEDURA E DHËNIES SË SHPËRBLIMIT TË PUNONJËSVE

1. Për të përfituar shpërblimet stimuluese për efektivitetin e shërbimeve dhe për kryerjen e shërbimeve me rrezikshmëri të veçantë, duhet që, brenda njëperiudhe 6-mujore të vitit kalendarik (janar-qershor/korrik-dhjetor), administrata tatimore të ketë tejkaluar planin e të ardhurave tatimore (përfshirë kontributet), për të paktën 3 muaj. Me plotësimin e këtij kriteri, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve udhëzon drejtorët e drejtorive në aparatin e DPT-së dhe drejtorët rajonalë që të propozojnë listën e punonjësve që duhet të marrin shpërblim.

2. Drejtorët e drejtorive në aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe drejtorët e drejtorive rajonale tatimore i paraqesin drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve propozimet konkrete për shpërblimin stimulues të punonjësve të varësisë së tyre, bazuar në efektivitetin në punë, si dhe për shpërblimin e punonjësve të strukturave hetimore për kryerjen e shërbimeve me rrezikshmëri të veçantë.

Propozimet duhet të jenë të shoqëruara me një relacion argumentues lidhur me ushtrimin e detyrave funksionale nga punonjësit e propozuar për të përfituar shpërblim stimulues, si dhe të mbështetura në vlerësimin e fundit të punonjësit.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton listën përfundimtare dhe masën e shpërblimit për të gjithë punonjësit që do të përfitojnë shpërblimin stimulues. Masa e shpërblimit stimulues për çdo punonjës bazohet në pagën mujore të punonjësit të propozuar e të miratuar për shpërblim, por, në asnjë rast, kjo masë nuk mund të kalojë vlerën e gjashtë pagave mujore në vit. Përlllogaritja e shpërblimit kushtëzohet gjithashtu nga fondi në dispozicion për këto shpërblime.

4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave miraton masën e shpërblimit për drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve.

5. Përjashtohen nga shpërblimi stimulues dhe nuk mund të propozohen për shpërblim punonjësit e administratës tatimore qendrore:

a) ndaj të cilëve janë marrë masa disiplinore për shkelje gjatë kryerjes së detyrës, brenda 6-mujorit të cilit i përket periudha e të ardhurave që do të shpërndahen;

b) të pezulluar për ushtrimin e detyrave të tyre funksionale sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

c) që kanë kërkuar dhe të cilëve u është miratuar leje pa të drejtë rroge përgjatë periudhës për të cilën do të jepet shpërblimi.

6. Struktura përgjegjëse për financën në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kryen ekzekutimin e shpërblimeve për punonjësit e aparatit të DPT-së, vetëm pas miratimit të listave e të masës së shpërblimit nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe pas miratimit nga sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave i masës së shpërblimit të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

7. Struktura përgjegjëse për financën në Drejtorinë Rajonale Tatimore kryen ekzekutimin e shpërblimeve për punonjësit e Drejtorisë Rajonale Tatimore vetëm pas miratimit të listave dhe masës së shpërblimit nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

8. Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore kryen depozitimin e dokumentacionit të plotë të përdorur për shpërblimin e punonjësve, i cilimbahet dhe administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe tëkopjes së listës së punonjësve që përfitojnë shpërblim, për të bërë shënimet e nevojshme në dosjen e çdo punonjësi.

IV. PROCEDURA E PËRDORIMIT TË SHPENZIMEVE PËR INVESTIME

1. Fondi limit i krijuar dhe i miratuar nga ministri sipas pikës 2, të ndarjes II, të këtij vendimi, përdoret për investime, nëpërmjet të cilave synohen përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës së mbledhjes të të ardhurave dhe që nuk janë të financuara nga buxheti i shtetit.

2. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e planit të investimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve i propozon drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve planet konkrete për investime me qëllim përmirësimin e modernizimin e ambienteve të punës, të pafinancuara nga buxheti i shtetit për administratën tatimore qendrore, të shoqëruara me preventiv financiar të detajuar. Lista e projektinvestimeve shqyrtohet dhe analizohet edhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.



V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pika 4, e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Udhëzimi nr. 18, datë 10.10.2014, i ministrit të Financave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe rregullave të përfitimit të shpërblimit të personelit tatimor”, shfuqizohet.

V. DISPOZITË KALIMTARE

Përfundimisht, për vitin 2015, punonjësit e tatiimeve do të shpërblehen nga fondi limit i miratuar nga ministri i Financave, pavarësisht nga kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 993, datë 9.12.2015

**PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E SEKRETARIATIT
KOMBËTAR TË NISMËS PËR
TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË
NXJERRËSE (EITI-SHQIPËRI), NË
KUADËR TË ANËTARËSIMIT NË
ORGANIZIMIN NDËRKOMBËTAR EITI-
INTERNATIONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sekretariati për Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqipëri) është institucion qendror, person juridik, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë, që ushtron funksionet në kuadër të anëtarësimit në organizimin ndërkombëtar “EITI-International”. Sekretariati organizohet si drejtori e përgjithshme dhe e ka selinë e tij në Tiranë.

2. Misioni i sekretariatit është përmbushja e prioriteteve dhe strategjive kombëtare për transparencë në industrinë nxjerrëse. Sekretariati koordinon përpjekjet kombëtare, në zbatim të standardit global EITI, që rrjedhin si detyrim nga anëtarësimi, për të siguruar transparencë të plotë të

të gjitha taksave dhe pagesave që kryhen nga industritë e naftës, gazit, minierave dhe burimeve të tjera natyrore, me kontribut material në buxhetin e shtetit, proceseve respektive, si dhe përgatitjen e menaxhimit të projekteve, në lidhje me këto fusha.

3. Sekretariati e zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në standardet e përcaktuara nga “EITI-International”, si dhe në përputhje me legjislacionin vendas. Standardi teknik, dokumentacioni përkatës dhe mënyra e raportimit përcaktohen nga EITI-International, ndërsa veprimtaria administrative e sekretariatit mbikëqyret, rregullohet dhe miratohet nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe industrinë dhe institucionet e tjera, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

4. Sekretariati (EITI-Shqipëri) ushtron veprimtarinë në marrëdhënie me të gjitha subjektet e përfshira në sektorin e industrive nxjerrëse. Vendimmarja në sekretariat realizohet në përputhje me standardin global EITI, nëpërmjet grupit ndërinstitucional të punës, i cili ngrihet me urdhër të Kryeministrit dhe funksionon si një platformë trepalëshe, me përfaqësues nga shoqëria civile, institucionet shtetërore përkatëse dhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitetin në industri.

5. Detyrat dhe objektivat e sekretariatit, në zbatim të kërkesave të standardeve EITI, janë:

a) Ngritja e strukturës së nevojshme, në mbështetje të programit të veprimeve të miratuara për EITI-Shqipëri;

b) Publikimi i raporteve EITI, garantimi i procesit të auditimit dhe plotësimi i procedurave për hartimin e raportit të miratimit;

c) Përcaktimi, në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional të punës dhe ministrinë e linjës, i objektivave kombëtarë të zbatimit të EITI-t;

ç) Rishikimi i bazës ligjore, për të reflektuar në legjislacionin përkatës kërkesat e standardit EITI, si dhe për të evidentuar pengesat e ndryshme për zbatimin e tij;

d) Identifikimi i burimeve të qëndrueshme të financimit, për zbatimin e planit kombëtar për EITI-n, si dhe monitorimi i tyre;

dh) Publikimi dhe shpërndarja e raporteve;

e) Ndjekja e një strategjie komunikimi dhe informimi, referuar standardit global EITI dhe strategjisë kombëtare për transparencë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

ë) Ngritja e kapaciteteve/trajnimi i punonjësve shtetërorë, i shoqërisë civile, ku përfshihet edhe



media, si dhe grupeve të interesit, të lidhura me EITI-n.

f) Trajnimi i nëpunësve të EITI-t, në përputhje me programin e zbatimit kombëtar për EITI-Shqipëri.

g) Raportimi, para grupit ndërinstitucional të punës, në mënyrë periodike, për ecurinë e realizimit të veprimtarive të programit dhe të hapave të anëtarësimit.

gj) Zgjerimi i fushës së veprimit të EITI-t edhe në fusha të tjera të burimeve natyrore.

h) Evidentimi dhe realizimi i projekteve të ndryshme, në lidhje me transparencën dhe antikorrupsionin në industrinë nxjerrëse dhe atë hidroenergetike.

6. Sekretariati, për të realizuar misionin dhe objektivat e tij, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë e tij me grupin ndërinstitucional të punës të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) dhe me institucione të tjera, publike dhe/ose private, me grupet e interesit, shoqërinë civile, median vendase dhe/ose të huaj. Përveç stafit teknik të përhershëm, sekretariati, kur e shihet të arsyeshme, për të realizuar misionin dhe objektivat e tij, mund të kontraktojë shërbime këshillimi nga ekspertë të jashtëm, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Sekretariati raporton në çdo mbledhje të grupit ndërinstitucional të punës të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI) dhe çdo vit, në mënyrë periodike, përgatit informacion me shkrim për Kryeministrin, për ecurinë e realizimit të programit të veprimeve dhe të raportit vjetor të EITI-t.

8. Sekretariati financohet nga:

a) buxheti i shtetit (fonde të destinuar për programin e veprimeve të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI);

b) burime financiare nga palë të treta, të destinuar për programin e veprimeve të EITI-t, nga fonde të institucioneve ndërkombëtare, të shteteve të veçanta dhe të organizatave të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe “Udhëzimet globale EITI për financim të institucioneve”;

c) donacione të subjekteve fizike dhe/ose juridike, nga sektori privat, vendas dhe/ose i huaj, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe “Udhëzimet globale EITI për financim të institucioneve”.

Buxheti i EITI-t miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë dhe industrinë.

9. Sekretariati e përdor buxhetin për fondin e pagave të punonjësve dhe për shpenzime të tjera, në funksion të përmbushjes së misionit dhe të detyrave të tij.

10. Drejtuesi i sekretariatit përfaqëson sekretariatin në marrëdhënie me të tretët. Marrëdhëniet e punës së drejtuesit të sekretariatit rregullohen me legjislacionin për nëpunësin civil.

11. Struktura organizative e sekretariatit miratohet me urdhër të Kryeministrin. Pagat e nëpunësve të sekretariatit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

12. Funksionimi i sekretariatit bazohet në rregulloren e funksionimit, e cila hartohet nga strukturat e tij dhe miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë dhe industrinë.

13. EITI-Shqipëri punëson, pranë strukturave të tij, staf ekspertësh teknikë, të cilët përzgjidhen në përputhje me legjislacionin për nëpunësin civil dhe procedurat e përzgjedhjes së EITI-International, me kriteret teknike të përcaktuara, sipas karakteristikave të projekteve që do të menaxhohen. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të sekretariatit rregullohen me legjislacionin për nëpunësin civil.

14. Vendimi nr. 540, datë 7.7.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen dhe funksionimin e sekretariatit, për ndjekjen e procedurave të anëtarësimit të Shqipërisë, si vend zbatues, në Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)”, të ndryshuar, shfuqizohet.

15. Ngarkohet ministri i Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 994, datë 9.12.2015

PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS NË PRONËSI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të



ndryshuar, dhe të neneve 25 e 45, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Regjistrimi i fitimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, me aktin e marrjes së tokës në pronësi, në vijim të AMTP-së, të nxjerrë në zbatim të ligjeve nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar, nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, të ndryshuar, nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, nr. 57/2012, “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, dhe të vendimit nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore”, të ndryshuar, bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP), në përputhje me nenet 25 e 45, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pas verifikimit nëse AMTP-ja përmban elementet e formës dhe përmbajtjes, si më poshtë vijon:

a) Emrin dhe mbiemrin e përfituesit apo të përfaqësuesit të familjes bujqësore, përfituese të tokës bujqësore;

b) Identifikimin e organit që e ka lëshuar AMTP-në, që përfaqësohet nga kryetari i komisionit të ndarjes së tokës, për aktet e lëshuara deri në 15.8.2008, ose nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, për AMTP-të e lëshuara në zbatim të ligjeve nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, nr. 57/2012 dhe nr. 171/2014;

c) Të dhënat identifikuese të pasurisë/ve të dhëna në pronësi: ku detyruese janë numri kadastral apo toponimi i ngastrës/ve, sipërfaqja dhe lloji i tokës bujqësore;

ç) Njërin nga vulat e mëposhtme:

- i) të komitetit ekzekutiv të fshatit të bashkuar;
- ii) të kryeplakut;
- iii) të njësisë së qeverisjes vendore;
- iv) të ndërmarrjes bujqësore;

v) të këshillit të rrethit/këshillit të qarkut.

d) Përputhjen e llojit të pasurisë së disponuar me AMTP-në me ndonjërin nga llojet e pasurive të kadastruara në zërin “Tokë bujqësore”, më 1.8.1991, të përcaktuara në shkronjën “a”, të nenit 1, të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar;

dh) AMTP-në origjinale ose të njëzuar me origjinalin, apo dublikatën e lëshuar nga njësia e qeverisjes vendore apo këshilli i qarkut.

2. Kur pasuria e përfituar me AMTP, në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, figuron e regjistruar në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, veprohet, si më poshtë vijon:

2.1. Kur pasuria nuk figuron në pronësi të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, si pasojë e transaksionit të realizuar me të tretë, ose e shpronësimit, të kryer për interes publik, me përjashtim të kalimit të pronësisë nëpërmjet akteve të trashëgimisë, e reflektuar kjo në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të tretët nuk ndalohen të kryejnë veprime, me përjashtim të rastit kur kjo pasuri krijon mbivendosje me një pasuri tjetër të paluajtshme, e cila nuk rrjedh nga e njëjta origjinë;

2.2. Kur pasuria e fituar me AMTP figuron ende në pronësi të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore ose trashëgimtarëve të tij, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në rastet e trajtimit të kërkesave për shërbim të subjekteve të ndryshme, verifikojnë ligjshmërinë e regjistrimit të kryer dhe veprojnë, si më poshtë vijon:

a) Nëse rezulton se regjistrimi është kryer në përputhje me ligjin, atëherë vijohet me realizimin e shërbimit të aplikuar;

b) Kur, gjatë verifikimit, rezulton se regjistrimi ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin, konstatimet e kryera, nga punonjësit që përpunojnë praktikën, i referohen regjistruarit, me shkrim, duke treguar, hollësisht, mangësitë e konstatuara.

Regjistrimi, në origjinë, i tokës bujqësore, ka mangësi, në rastet kur:

i) është kryer me mungesën e një apo më shumë elementeve të akteve të marrjes së tokës në pronësi, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi;

ii) aktet e marrjes së tokës në pronësi nuk administrohen në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose administrohen si fotokopje;



iii) sipërfaqja e të gjitha pasurive, dhënë me AMTP, del e ndryshme nga sipërfaqja e regjistrimit fillestar të këtyre pasurive, e pasqyruar në kartelat e tyre respektive.

c) Kur janë konstatuar një apo më shumë nga mangësitë e përmendura në nënndarjet “i”, të shkronjës “b”, të kësaj pike, brenda dy ditëve pune, nga data e konstatimit, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet toka bujqësore e pasqyruar në AMTP. Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkruuese të faktit, si dhe argumentimin e mangësive të konstatuara. Relacionit, detyrimisht, i bashkëlidhet edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve/dokumenteve që konstatojnë këto mangësi, si dhe një kopje e kartelës së pasurisë së mbajtësit të fundit të titullit të pronësisë, së bashku me gjeneralitetet e tij dhe adresën, në rast se këto të dhëna administrohen në zyrën e regjistrimit.

Pas verifikimit të mangësive, bashkia duhet të kthejë, zyrtarisht, përgjigje në ZVRPP, duke plotësuar mangësitë e evidentuara. Plotësimi i mangësive nuk bëhet në AMTP-në konkrete, por duke i përshkruar ato shkresërisht.

ç) Kur në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme AMTP-ja administrohet në fotokopje ose mungon, ZVRPP-ja, brenda dy ditëve pune, nga data e konstatimit, i drejtohet mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, bashkisë dhe DAMT-it, pranë këshillit të qarkut, me kërkesën që, nëse disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, ta paraqesin në ZVRPP. Kërkesës i bashkëlidhet edhe një kopje e akteve/dokumenteve që disponon ZVRPP-ja. Mbajtësi i parë i titullit të pronësisë, bashkia dhe DAMT-i, pranë këshillit të qarkut, kthejnë përgjigje brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike.

Nëse mbajtësi i parë i titullit të pronësisë, bashkia apo DAMT-i nuk disponojnë kopjen origjinale të AMTP-së, bashkia përkatëse, bazuar në dokumentacionin e dërguar nga ZVRPP-ja, ku përfshihet edhe kopja e AMTP-së, bën verifikimin faktik të tokës bujqësore që zotërohet nga familja bujqësore dhe plotëson AMTP-në, me shënimin dublikatë, e cila i dërgohet, zyrtarisht, zyrës së regjistrimit.

Në rastin kur mbajtësi i parë i titullit të pronësisë, bashkia apo DAMT-i nuk disponojnë kopje të AMTP-së, mbajtësi i parë i titullit të pronësisë i drejtohet, me kërkesë, bashkisë, për

plotësimin e AMTP-së, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, ose të ligjeve nr. 57/2012 dhe nr. 171/2014.

d) Kur sipërfaqja e të gjitha pasurive, të dhëna me AMTP-në, del e ndryshme nga sipërfaqja e regjistrimit fillestar të këtyre pasurive, e pasqyruar në kartelat e tyre, ZVRPP-ja, brenda 2 (dy) ditëve pune, nga data e konstatimit, vë në dijeni mbajtësin e parë të titullit të pronësisë dhe bashkinë për të bërë saktësimin e planvendosjes, sipas sipërfaqes së çdo pasurie të dhënë me AMTP.

Në këtë rast, bashkia konfirmon planvendosjen dhe e përcjell atë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pranë ZVRPP-së, shoqëruar me relacionin përkatës dhe deklaratën noteriale të mbajtësit të parë të titullit të pronësisë, në të cilën shprehet se ai është dakord me saktësimin e bërë.

Në rast se sipërfaqja e të gjitha pasurive, të dhëna me AMTP, del më e madhe se sipërfaqja e regjistrimit fillestar të tyre, e pasqyruar në kartelat respektive, zyra vendore e regjistrimit vijon me realizimin e shërbimit të aplikuar, sipas të dhënave të AMTP-së.

Në rast se sipërfaqja e të gjitha pasurive, të dhëna me AMTP, del më e vogël se sipërfaqja e regjistrimit fillestar të tyre, e pasqyruar në kartelat respektive, zyra vendore e regjistrimit vijon me realizim e shërbimit të aplikuar, por sipërfaqja e tepërt i zbritet vetëm njërës prej pasurive, sipas deklaratës së përfituesit të AMTP-së.

Nëse mbajtësi i parë i titullit të pronësisë nuk dorëzon deklaratën noteriale, që është dakord me saktësimin e bërë, dhe ZVRPP-ja ka lëshuar më parë certifikatën e pronësisë për këtë pasuri të paluajtshme, regjistruesi bën shënimin në kartelën e pasurisë për mospërputhjen ndërmjet sipërfaqes së përcaktuar në AMTP dhe sipërfaqes sipas hartës kadastrale.

Nëse mbajtësi i parë i titullit të pronësisë nuk dorëzon deklaratën noteriale, që është dakord me saktësimin e bërë, dhe ZVRPP-ja nuk ka lëshuar më parë certifikatën e pronësisë për këtë pasuri të paluajtshme, regjistruesi bën shënimin në kartelën e pasurisë për mospërputhjen, ndërmjet sipërfaqes së përcaktuar në AMTP dhe sipërfaqes sipas hartës kadastrale, dhe nuk e lëshon certifikatën e pronësisë, duke argumentuar, me shkrim, mospërputhjen e konstatuar.

3. Kur pasuria, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk figuron e regjistruar në pronësi të



përfituesit, me ATMP, regjistrimi i saj do të bëhet:

a) gjatë procesit të regjistrimit fillestar, sistematik, të zonës kadastrale ku ajo ndodhet gjeografikisht;

b) me “kërkesë për regjistrim”, kur pasuria ndodhet në zona kadastrale për të cilat ka përfunduar regjistrimi sistematik i pasurive;

c) me “kërkesë për regjistrim në raste të veçanta”, kur pasuria ndodhet në zona kadastrale ku nuk ka filluar procesi i regjistrimit sistematik të pasurive.

3.1 Për rastet e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 3, të këtij vendimi, ZVRPP-ja procedon me regjistrimin e tyre në favor të përfituesit me AMTP, me kushtin që:

a) AMTP-të e lëshuara nga komisionet e ndarjes së tokës përpara datës 15.8.2008, të përmbajnë të gjitha elementet e formës dhe të përmbajtjes, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi. Nëse nuk plotësohet kushti i përcaktuar në këtë pikë, ZVRPP-ja nuk procedon me regjistrimin dhe, brenda 2 (dy) ditëve pune, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet toka bujqësore, për rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkuese të faktit, argumentimin e mangësive të konstatuara dhe duhet të ketë bashkëlidhur, detyrimisht, edhe një kopje e AMTP-së dhe akteve/dokumenteve që përmbajnë këto mangësi;

b) AMTP-të e lëshuara nga komisionet e ndarjes së tokës përpara datës 15.8.2008, të jenë të shoqëruara me planin e rlevimit/planvendosjen e ngastrave të përfshira në të dhe certifikatën e përbërjes familjare, në datën 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore, dhe në datën 1.8.1991, duke llogaritur ndryshimet në numrin e pjesëtarëve të saj deri më 1.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore. Nëse nuk plotësohet kushti i përcaktuar në këtë pikë, ZVRPP-ja nuk procedon me regjistrimin dhe, brenda 2 (dy) ditëve pune, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet komisionit vendor të verifikimit të titujve të pronësisë (KV), për rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkuese të faktit, argumentimin e mangësive/paligjshmërive të konstatuara dhe propozimin për verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore për marrjen e një vendimi, sipas nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për

shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Relacionit, detyrimisht, i bashkëlidhen edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve/dokumenteve që përmbajnë këto mangësi. Ky njoftim i dërgohet edhe subjektit përfitues, për plotësimin e mangësive.

c) ATMP-ja të përcillet zyrtarisht për regjistrim nga njëسيا e qeverisjes vendore;

ç) subjektet, në favor të të cilëve është lëshuar AMTP-ja, të kenë aplikuar për regjistrim pasurie në ZVRPP.

3.2 Për AMTP-të e lëshuara nga komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë”, ZVRPP-ja procedon me regjistrimin e saj në favor të përfituesit me AMTP, pasi të plotësohet kushti që:

a) AMTP-ja të përmbajë elementet dhe dokumentacionin shoqërues, të përcaktuar me vendimin nr. 224, datë 19.2.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)”. Nëse nuk plotësohet kushti i përcaktuar në këtë pikë, ZVRPP-ja nuk procedon me regjistrimin dhe, brenda 2 (dy) ditëve pune, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet komisionit vendor të verifikimit të titujve të pronësisë (KV), për plotësimin e mangësive. Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkuese të faktit dhe argumentimin e mangësive/paligjshmërive të konstatuara. Relacionit, detyrimisht, i bashkëlidhen edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve/dokumenteve që përmbajnë këto mangësi. Ky njoftim i dërgohet edhe subjektit përfitues;

b) ATMP-ja dhe dokumentacioni që e shoqëron atë të përcillet zyrtarisht, për regjistrim, nga komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë (KV);

c) subjekti, në favor të të cilit është lëshuar AMTP-ja, të ketë aplikuar për regjistrim pasurie në ZVRPP.

3.3 Për AMTP-të e lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë”, të ndryshuar, ZVRPP-ja procedon me regjistrimin e saj në favor



të përfituesit me AMTP, pasi të plotësohet kushti që:

a) AMTP-ja të përmbajë elementet dhe dokumentacionin shoqërues, të përcaktuar me vendimin nr. 253, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”, të ndryshuar. Nëse nuk plotësohet kushti i përcaktuar në këtë pikë, ZVRPP-ja nuk procedon me regjistrimin dhe, brenda 2 (dy) ditëve pune, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet njësisë së qeverisjes vendore, për plotësimin e mangësive, apo komisionit vendor të verifikimit të titujve të pronësisë (KV), për rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkuese të faktit, argumentimin e mangësive/paligjshmërive të konstatuara dhe propozimin për verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore për marrjen e një vendimi, sipas nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Relacionit, detyrimisht, i bashkëlidhen edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve /dokumenteve që përmbajnë këto mangësi. Ky njoftim i dërgohet edhe subjektit përfitues për plotësimin e mangësive;

b) ATMP-ja të përcillet zyrtarisht, për regjistrim, nga njësia e qeverisjes vendore;

c) subjekti, në favor të të cilit është lëshuar AMTP-ja, të ketë aplikuar për regjistrim pasurie në ZVRPP.

3.4 Për AMTP-të e lëshuara nga njësitet e qeverisjes vendore, në zbatim të ligjit nr. 57/2012, “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”, dhe të ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi përfituesve”, pasi të plotësohet kushti që:

a) AMTP-ja të përmbajë elementet e përcaktuara me vendimin nr. 222, datë 6.3.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, dhe me vendimin nr. 337, datë 22.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të

kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.

Nëse nuk plotësohet kushti i përcaktuar në këtë pikë, ZVRPP-ja nuk procedon me regjistrimin dhe, brenda 2 (dy) ditëve pune, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet njësisë së qeverisjes vendore, për plotësimin e mangësive, apo komisionit vendor të verifikimit të titujve të pronësisë (KV), për rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkuese të faktit, argumentimin e mangësive/paligjshmërive të konstatuara dhe propozimin për verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore për marrjen e një vendimi, sipas nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar. Relacionit, detyrimisht, i bashkëlidhen edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve/dokumenteve që përmbajnë këto mangësi. Ky njoftim i dërgohet edhe subjektit përfitues për plotësimin e mangësive;

b) ATMP-ja të përcillet zyrtarisht, për regjistrim, nga njësia e qeverisjes vendore;

c) subjekti, në favor të të cilit është lëshuar AMTP-ja, të ketë aplikuar për regjistrim pasurie në ZVRPP.

4.Në rastet kur në ZVRPP pasuria figuron e regjistruar si pasuri shtetërore dhe AMTP-ja ndodhet në ZRPP, procedohet, si më poshtë vijon:

a) ZVRPP-ja dërgon në bashkinë përkatëse një kopje të njësuar me origjinalin e AMTP-së;

b) Bashkia kryen veprimet, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

5. Në çdo rast, nëse ZVRPP-ja konstaton se lloji i pasurisë “tokë bujqësore” (arë, vreshtë, ullishtë, pemishte), dhënë me AMTP, nuk përputhet me llojin e pasurisë që figuron e regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme, me nismën e vet apo me kërkesë të mbajtësit të titullit të pronësisë, kërkon informacion nga DAMT-i, pranë këshillit të qarkut, për zërin kadastral të ngastrës, sipas regjistrave kadastralë më datë 1.8.1991. Nëse konstatohet:

a) parregullsi në sistemin e regjistrimit, korrigjohet zëri kadastral në kartelën përkatëse;

b) shkelje e nenit 2, të ligjit nr. 9948/2008, ZVRPP-ja i drejtohet komisionit vendor respektiv, me relacion të argumentuar, me qëllim shfuqizimin e plotë apo të pjesshëm të AMTP-së konkrete.



6. Në çdo rast, kur është i nevojshëm hartimi i planvendosjes së ngastrave për regjistrim apo korigjimi dhe saktësimi i tyre, bashkitë, me shpenzimet e tyre, ngarkojnë punonjës, topografë të licencuar, për përgatitjen e tyre. Planvendosjet, detyrimisht, duhet të jenë të konfirmuara nga bashkia përkatëse.

7. Udhëzimi nr. 2, datë 13.6.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen ministri i Drejtësisë, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Komisioni Qeveritar i Tokës, drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës, pranë këshillave të qarqeve, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 995, datë 9.12.2015

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TË
SIPËRFAQES SË TOKËS BUJQËSORE
PREJ 926.55 HA, NË PRONËSI
SHTETËRORE, DHËNË NË PËRDORIM
KOMUNAVE BUÇIMAS, ÇËRRAVË DHE
UDENISHT DHE PËR DISA NDRYSHIME
NË VENDIMET E KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NR. 244, DATË 4.4.2012, NR.
417, DATË 8.6.2011, DHE NR. 534, DATË
1.5.2008

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, dhe të shkronjës “b”, të nenit 14, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 (nëntëqind e njëzet e gjashtë pikë pesëdhjetë e pesë) ha, në pronësi shtetërore, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, dhënë në përdorim komunave Udenisht, Buçimas dhe Çërravë sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.

2. Sipërfaqja e tokës bujqësore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të administrohet sipas ligjit nr. 8318, datë 1.4.1988, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar, ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik/privat”, dhe vendimit nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”.

3. Në vendimin nr. 244, datë 4.4.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Buçimas, të qarkut të Korçës”, hiqet e drejta e përdorimit të pronës sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Në vendimin nr. 417, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Çërravë të qarkut të Korçës”, hiqet e drejta e përdorimit të pronës sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Në vendimin nr. 534, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Udenisht të qarkut të Korçës”, hiqet e drejta e përdorimit të pronës sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Punëve të Brendshme dhe Këshilli i Qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA E SIPËRFAQES SË TOKËS BUJQËSORE NË ADMINISTRIM TË MBZHRAU-së

Nr.	Komuna	Fshati	Zona kadastrale	Indeksi i hartës	Numri kadastral	Numri ipasurisë	Sip. në Ha	Lloji i pasurisë (arë, pemëtore, vresht)	Statusi aktual juridik i pronësisë sipas ZVRPP-së
	1	2		3	4	5	6	7	8
1	Udenisht	Lin	2457	K-34-102-(196-B)	5	5	3.75	arë	shtet
2				K-34-102-(196-B)	6	6	9.64	arë	shtet
3				K-34-102-(196-B)	7	7	0.33	arë	shtet
4				K-34-102-(196-B)	8	8	0.22	arë	shtet
5				K-34-102-(196-B)	11	11	0.10	arë	shtet
6				K-34-102-(196-B)	12	12	0.26	arë	shtet
7				K-34-102-(196-B)	13	13	2.12	arë	shtet
8				K-34-102-(196-B)	17	17	0.45	arë	shtet
9				K-34-102-(196-B)	18	18	0.18	arë	shtet
10				K-34-102-(196-B)	44	44	0.76	arë	shtet
11				K-34-102-(196-B)	45	45	1.08	arë	shtet
12				K-34-102-(196-B)	46	46	0.09	arë	shtet
13				K-34-102-(196-B)	48	48	0.08	arë	shtet
14				K-34-102-(196-B)	49	49	0.32	arë	shtet
15				K-34-102-(196-B)	50	50	0.53	arë	shtet
16				K-34-102-(196-B)	51	51	0.16	arë	shtet
17	Indeksi i hartës	Numri kadastral	Numri i pasurisë sipas ZVRPP-së	K-34-102-(196-B)	52	52	0.55	arë	shtet
18				K-34-102-(196-B)	50	50	0.53	arë	shtet
19				K-34-102-(196-B)	51	51	0.16	arë	shtet
20				K-34-102-(196-B)	52	52	0.55	arë	shtet
21				K-34-102-(196-D)	54	54	0.47	arë	shtet
22				K-34-102-(196-D)	56	56	0.47	arë	shtet
23				K-34-102-(196-D)	57	57	0.42	arë	shtet
24				K-34-102-(196-D)	58	58	4.59	arë	shtet
25				K-34-102-(196-D)	59	59	0.08	arë	shtet
26				K-34-102-(196-D)	61	61	0.16	arë	shtet
27				K-34-102-(196-D)	62	62	0.60	arë	shtet
28				K-34-102-(196-D)	63	63	0.80	arë	shtet
29				K-34-102-(196-D)	64	64	0.51	arë	shtet
30				K-34-102-(196-D)	65	65	0.12	arë	shtet
31				K-34-102-(196-D)	66	66	0.16	arë	shtet
32				K-34-102-(196-D)	68	68	0.20	arë	shtet
33				K-34-102-(196-D)	69	69	0.02	arë	shtet
34				K-34-102-(196-D)	70	70	0.04	arë	shtet
35				K-34-102-(196-D)	87	87	0.14	arë	shtet
36				K-34-102-(196-D)	89	89	0.57	arë	shtet
37				K-34-102-(196-D)	90	90	0.70	arë	shtet
38				K-34-102-(196-D)	91	91	0.22	arë	shtet
39				K-34-102-(196-D)	93	93	2.58	arë	shtet
40				K-34-102-(196-D)	94	94	0.44	arë	shtet
41				K-34-102-(196-D)	96	96	8.39	pemëtore	shtet
42				K-34-102-(196-D)	98	98	1.11	pemëtore	shtet
43				K-34-102-(196-D)	100	100	0.10	arë	shtet
44				K-34-102-(196-D)	101	101	5.58	arë	shtet
45				K-34-102-(196-D)	104	104	21.50	pemëtore	shtet
46				K-34-102-(196-D)	106	106	0.08	arë	shtet
47				K-34-102-(196-D)	108	108	0.08	arë	shtet
48				K-34-102-(196-D)	110	110	0.24	arë	shtet
49				K-34-102-(196-D)	111	111	0.91	arë	shtet
50				K-34-102-(196-D)	112	112	3.50	arë	shtet
51				K-34-102-(212-B)	142/2	142/2	0.90	arë	shtet
52				K-34-102-(212-B)	144	144	0.27	arë	shtet
53				K-34-102-(212-B)	145	145	0.16	arë	shtet
54				K-34-102-(212-B)	146	146	0.16	arë	shtet
55				K-34-102-(212-B)	147	147	0.24	arë	shtet
56				K-34-102-(196-D)	112	112	3.50	arë	shtet
57				K-34-102-(196-D)	142/2	142/2	0.90	arë	shtet
58				K-34-102-(196-D)	144	144	0.27	arë	shtet
59				K-34-102-(196-D)	145	145	0.16	arë	shtet
60				K-34-102-(196-D)	146	146	0.16	arë	shtet



61			K-34-102-(196-D)	147	147	0.24	arë	shtet
62			K-34-102-(212-B)	148	148	0.08	arë	shtet
63			K-34-102-(212-B)	149	149	0.10	arë	shtet
64			K-34-102-(212-B)	150	150	0.35	arë	shtet
65			K-34-102-(212-B)	152	152	4.16	arë	shtet
66			K-34-102-(212-B)	154	154	9.34	arë	shtet
67			K-34-102-(212-B)	158	158	1.50	arë	shtet
68			K-34-102-(212-B)	159	159	0.48	arë	shtet
69			K-34-102-(212-B)	160	160	0.21	arë	shtet
70			K-34-102-(212-B)	161	161	0.01	arë	shtet
71			K-34-102-(212-B)	165	165	4.49	arë	shtet
72			K-34-102-(212-B)	166	166	0.50	arë	shtet
73			K-34-102-(212-B)	167	167	1.91	arë	shtet
74			K-34-102-(212-B)	169	169	0.10	arë	shtet
75			K-34-102-(212-B)	170	170	0.10	arë	shtet
76			K-34-102-(212-B)	172	172	0.04	arë	shtet
77			K-34-102-(212-B)	173	173	1.70	arë	shtet
78			K-34-102-(212-B)	174	174	6.80	arë	shtet
79			K-34-102-(212-B)	175	175	0.68	arë	shtet
80			K-34-102-(212-B)	177	177	0.07	arë	shtet
81			K-34-102-(212-B)	178/6	178/6	3.03	arë	shtet
82			K-34-102-(212-B)	178/5	178/5	1.00	arë	shtet
83			K-34-102-(212-B)	179	179	0.91	pemëtore	shtet
84			K-34-102-(212-B)	324	324	0.05	arë	shtet
85			K-34-102-(212-B)	325	325	0.03	arë	shtet
86			K-34-102-(212-B)	326	326	0.20	arë	shtet
87			K-34-102-(212-B)	327	327	5.05	arë	shtet
88			K-34-102-(212-B)	179	179	0.91	pemëtore	shtet
89			K-34-102-(212-B)	324	324	0.05	arë	shtet
90			K-34-102-(212-B)	325	325	0.03	arë	shtet
91			K-34-102-(212-B)	326	326	0.20	arë	shtet
92			K-34-102-(212-B)	327	327	5.05	arë	shtet
93			K-34-102-(212-B)	328	328	0.14	arë	shtet
94			K-34-102-(212-B)	332/1	332/1	0.24	arë	shtet
95			K-34-102-(212-B)	330	330	0.07	arë	shtet
96			K-34-102-(212-B)	331	331	0.21	arë	shtet
97			K-34-102-(212-B)	332/3	332/3	0.38	arë	shtet
98			K-34-102-(212-B)	334	334	2.24	pemëtore	shtet
99			K-34-102-(212-B)	337	337	0.08	arë	shtet
100			K-34-102-(212-B)	338	338	1.22	arë	shtet
Shuma						137.31		
1	Buqezë	1317	K-34-102-(212-B)	340	340	0.07	arë	shtet
2			K-34-102-(212-B)	343	343	0.10	arë	shtet
3			K-34-102-(212-B)	344	344	2.04	arë	shtet
4			K-34-102-(212-B)	345	345	0.33	arë	shtet
5			K-34-102-(212-B)	346	346	0.37	arë	shtet
6			K-34-102-(212-B)	347	347	0.82	arë	shtet
7			K-34-102-(212-B)	348	348	0.20	arë	shtet
8			K-34-102-(212-B)	349	349	0.98	arë	shtet
9			K-34-102-(212-B)	350	350	0.07	arë	shtet
10			K-34-102-(212-B)	351	351	0.12	arë	shtet
11			K-34-102-(212-B)	353	353	0.32	arë	shtet
12			K-34-102-(212-B)	354	354	0.63	arë	shtet
13			K-34-102-(212-B)	356	356	0.54	arë	shtet
14			K-34-102-(212-B)	357	357	0.04	arë	shtet
15			K-34-102-(212-D)	359	359	0.04	arë	shtet
16			K-34-102-(212-D)	360	360	0.18	arë	shtet
17			K-34-102-(212-D)	361	361	0.04	arë	shtet
18			K-34-102-(212-D)	362	362	0.05	arë	shtet
19			K-34-102-(212-D)	363	363	0.86	arë	shtet
20			K-34-102-(212-D)	364	364	0.16	arë	shtet
21			K-34-102-(212-D)	365	365	0.39	arë	shtet
22			K-34-102-(212-D)	366	366	0.17	arë	shtet
Shuma						8.52		
1	Piskupat	2973	K-34-102-(212-D)	336/1	336/1	9.07	arë	shtet
2			K-34-102-(212-D)	336/2	336/2	18.15	arë	shtet
3			K-34-102-(212-D)	389	389	50.49	arë	shtet
4			K-34-102-(212-D)	391	391	3.65	arë	shtet
5			K-34-102-(212-D)	392	392	0.85	arë	shtet



6				K-34-102-(212-D)	395	395	2.16	arë	shtet
7				K-34-102-(212-D)	397	397	3.39	arë	shtet
8				K-34-102-(212-D)	398	398	0.99	arë	shtet
9				K-34-102-(212-D)	399	399	1.59	arë	shtet
10				K-34-102-(212-D)	551	551	0.17	arë	shtet
11				K-34-102-(212-D)	552	552	1.30	arë	shtet
12				K-34-102-(212-D)	554	554	0.12	arë	shtet
13				K-34-102-(212-D)	557	557	0.13	arë	shtet
Shuma							92.06		
	UdenishtTOTAL						237.89		
1	Buçimas	Guras	1903	K-34-114-(88-B)	143	143	31.30	arë	shtet
2				K-34-114-(88-B)	145	145	2.58	arë	shtet
3				K-34-114-(88-B)	146	146	0.34	arë	shtet
4				K-34-114-(88-C)	203/2	203/2	1.66	arë	shtet
5				K-34-114-(87-D)	205/22	205/22	44.59	arë	shtet
6				K-34-114-(88-A)	209	209	6.05	arë	shtet
7				K-34-114-(88-A)	210	210	4.67	arë	shtet
8				K-34-114-(88-A)	211/1	211/1	8.64	arë	shtet
9				K-34-114-(88-A)	211/2	211/2	4.72	arë	shtet
Shuma							104.55		
1		Gështenjas	1711	K-34-114-(104-A)	172/476	172/476	3.66	arë	shtet
2				K-34-114-(103-B)	170/35	170/35	42.50	arë	shtet
3				K-34-114-(104-A)	173/5	173/5	13.80	arë	shtet
4				K-34-114-(104-A)	175	175	25.40	pemëto	shtet
5				K-34-114-(103-D)	178	178	8.59	pemëto	shtet
6				K-34-114-(89-B)	179	179	20.54	pemëto	shtet
Shuma							114.49		
1		Peshkëpi	2928.00	K-34-114-(89-B)	58	58	3.90	pemëto	shtet
2				K-34-114-(89-B)	72	72	0.56	arë	shtet
3				K-34-114-(89-B)	73	73	0.62	arë	shtet
4				K-34-114-(89-B)	74	74	0.99	arë	shtet
5				K-34-114-(89-B)	75	75	0.38	arë	shtet
6				K-34-114-(89-B)	76/1	76/1	0.28	arë	shtet
7				K-34-114-(89-B)	76/3	76/3	0.69	arë	shtet
8				K-34-114-(89-B)	76/4	76/4	0.75	arë	shtet
9				K-34-114-(89-B)	76/5	76/5	0.93	arë	shtet
10				K-34-114-(89-B)	76/6	76/6	0.55	arë	shtet
11				K-34-114-(89-A)	84/5	84/5	2.73	arë	shtet
12				K-34-114-(89-A)	84/22	84/22	3.15	arë	shtet
13				K-34-114-(89-A)	87/15	87/15	2.13	arë	shtet
14				K-34-114-(89-A)	97	97	11.00	arë	shtet
15				K-34-114-(89-A)	98	98	1.38	arë	shtet
16				K-34-114-(89-C)	120/2	120/2	0.84	arë	shtet
17				K-34-114-(89-C)	120/3	120/3	2.55	arë	shtet
18				K-34-114-(89-C)	120/4	120/4	0.49	arë	shtet
19				K-34-114-(89-C)	128/1	128/1	0.51	arë	shtet
20				K-34-114-(89-C)	128/2	128/2	0.60	arë	shtet
21				K-34-114-(89-C)	128/3	128/3	0.59	arë	shtet
22				K-34-114-(89-C)	128/4	128/4	0.60	arë	shtet
23				K-34-114-(89-C)	128/5	128/5	0.90	arë	shtet
24				K-34-114-(89-C)	128/6	128/6	0.71	arë	shtet
25				K-34-114-(89-C)	128/7	128/7	0.88	arë	shtet
26				K-34-114-(89-C)	128/8	128/8	0.35	arë	shtet
27				K-34-114-(89-C)	128/11	128/11	1.98	arë	shtet
Shuma							41.04		
	Buçimas TOTAL						260.08		
1	Çërravë	Bletas	1214	K-34-114-(121-B)	255/10	255/10	16.60	arë	shtet
2				K-34-114-(121-B)	269	269	4.12	arë	shtet
3				K-34-114-(122-B)	321	321	0.64	pemëto	shtet
4				K-34-114-(122-B)	322	322	2.30	pemëto	shtet
5				K-34-114-(122-A)	323/3	323/3	0.15	arë	shtet
6				K-34-114-(122-A)	332/8	332/8	1.99	arë	shtet
7				K-34-114-(122-A)	342	342	0.75	arë	shtet
8				K-34-114-(122-C)	522	522	1.77	arë	shtet
9				K-34-114-(122-C)	524	524	1.65	arë	shtet
Shuma							29.82		



1		Alarup	1008	K-34-114-(90-A)	1/4	1/4	4.74	arë	shtet
2				K-34-114-(90-A)	3	3	4.65	arë	shtet
3				K-34-114-(90-A)	5	5	0.36	arë	shtet
4				K-34-114-(90-A)	8	8	0.34	arë	shtet
5				K-34-114-(90-A)	9	9	1.05	arë	shtet
6				K-34-114-(90-A)	10/2	10/2	1.30	arë	shtet
7				K-34-114-(90-B)	13	13	0.50	arë	shtet
8				K-34-114-(90-B)	14	14	0.37	arë	shtet
9				K-34-114-(90-B)	15	15	0.84	arë	shtet
10				K-34-114-(90-B)	16	16	0.25	arë	shtet
11				K-34-114-(90-B)	17	17	0.22	arë	shtet
12				K-34-114-(90-B)	18	18	0.20	arë	shtet
13				K-34-114-(90-A)	22	22	1.04	arë	shtet
14				K-34-114-(90-A)	23	23	0.29	arë	shtet
15				K-34-114-(90-A)	25/11	25/11	2.73	arë	shtet
16				K-34-114-(90-C)	30	30	0.36	arë	shtet
17				K-34-114-(90-C)	31/5	31/5	0.97	arë	shtet
18				K-34-114-(90-A)	33	33	0.59	arë	shtet
19				K-34-114-(90-A)	36	36	0.79	arë	shtet
20				K-34-114-(90-D)	68	68	0.73	arë	shtet
21				K-34-114-(90-D)	69	69	0.45	arë	shtet
22				K-34-114-(90-D)	70	70	0.33	arë	shtet
23				K-34-114-(106-B)	76	76	0.16	arë	shtet
24				K-34-114-(106-B)	78	78	0.36	arë	shtet
25				K-34-114-(106-B)	91	91	2.77	arë	shtet
26				K-34-114-(106-B)	95	95	8.00	arë	shtet
27				K-34-114-(106-B)	133	133	2.64	arë	shtet
28				K-34-114-(106-B)	710	710	0.14	arë	shtet
29				K-34-114-(106-B)	717	717	0.72	arë	shtet
30				K-34-114-(106-B)	718	718	0.10	arë	shtet
31				K-34-114-(106-B)	719	719	0.10	arë	shtet
32				K-34-114-(106-B)	720	720	0.10	arë	shtet
33				K-34-114-(106-B)	721	721	0.30	arë	shtet
34				K-34-114-(106-B)	722	722	0.10	arë	shtet
35				K-34-114-(106-B)	723	723	0.15	arë	shtet
36				K-34-114-(106-B)	724	724	0.44	arë	shtet
37				K-34-114-(106-B)	725	725	0.20	arë	shtet
38				K-34-114-(106-B)	726	726	0.34	arë	shtet
39				K-34-114-(106-B)	727	727	2.20	arë	shtet
40				K-34-114-(106-B)	728	728	1.02	arë	shtet
41				K-34-114-(106-B)	729	729	0.32	arë	shtet
42				K-34-114-(106-B)	730	730	0.22	arë	shtet
43				K-34-114-(106-B)	731	731	0.64	arë	shtet
44				K-34-114-(106-B)	732	732	0.47	arë	shtet
45				K-34-114-(106-B)	733	733	0.64	arë	shtet
46				K-34-114-(106-B)	734	734	0.24	arë	shtet
47				K-34-114-(106-B)	735	735	1.11	arë	shtet
48				K-34-114-(106-B)	736	736	0.24	arë	shtet
49				K-34-114-(106-B)	737	737	0.06	arë	shtet
50				K-34-114-(106-B)	738	738	0.14	arë	shtet
51				K-34-114-(106-B)	739	739	0.18	arë	shtet
52				K-34-114-(106-B)	740	740	0.36	arë	shtet
53				K-34-114-(106-B)	741	741	0.54	arë	shtet
54				K-34-114-(106-B)	742	742	0.49	arë	shtet
55				K-34-114-(106-B)	832	832	5.55	arë	shtet
Shuma							54.14		
1		Çërravë	1387	K-34-114-(104-B)	67	67	0.22	arë	shtet
2				K-34-114-(104-B)	68	68	0.64	arë	shtet
3				K-34-114-(104-A)	71	71	4.53	pemëtore	shtet
4				K-34-114-(104-C)	73	73	3.05	arë	shtet
5				K-34-114-(104-B)	74	74	0.79	arë	shtet
6				K-34-114-(104-C)	75	75	2.04	arë	shtet
7				K-34-114-(104-C)	77	77	0.59	arë	shtet
8				K-34-114-(104-C)	83	83	0.36	arë	shtet
9				K-34-114-(104-C)	105	105	4.94	arë	shtet
10				K-34-114-(104-B)	39	39	1.30	arë	shtet
11				K-34-114-(104-C)	100	100	1.40	arë	shtet
12				K-34-114-(104-C)	255	255	0.34	arë	shtet
13				K-34-114-(104-C)	256	256	1.26	arë	shtet
14				K-34-114-(104-C)	266/1,2,3	266/1,2,3	18.35	arë	shtet



15			K-34-114-(104-C)	382	382	7.56	arë	shtet
			K-34-114-(104-C)	441/6	441/6	2.1	arë	shtet
Shuma						49.47		
1	Pretushë	3047	K-34-114-(136-A)	2	2	52.8	arë	shtet
2			K-34-114-(136-A)	8	8	12.2	arë	shtet
3			K-34-114-(136-B)	9	9	4.03	arë	shtet
4			K-34-114-(136-B)	11	11	2.37	arë	shtet
5			K-34-114-(136-B)	13/51	13/51	7.6	pemëtores	shtet
6			K-34-114-(136-C)	17	17	2.3	arë	shtet
7			K-34-114-(136-B)	31	31	2.92	arë	shtet
8			K-34-114-(136-B)	32	32	2.45	arë	shtet
9			K-34-114-(136-A)	44	44	3.04	pemëtores	shtet
10			K-34-114-(136-A)	48	48	5.21	arë	shtet
11			K-34-114-(136-B)	53	53	3.9	arë	shtet
12			K-34-114-(135-D)	54	54	22.38	arë	shtet
13			K-34-114-(136-C)	111/9	111/9	22.34	arë	shtet
14			K-34-114-(136-D)	139/40	139/40	6.92	arë	shtet
15			K-34-114-(136-D)	140	140	1.8	arë	shtet
Shuma						152.26		
1	Nizhavec	2808	K-34-114-(153-A)	184/1	184/1	10.77	arë	shtet
2			K-34-114-(153-A)	184/3	184/3	1.23	arë	shtet
3			K-34-114-(153-A)	185/1	185/1	2.65	pemëtores	shtet
4			K-34-114-(153-A)	185/2	185/2	1.4	pemëtores	shtet
5			K-34-114-(153-B)	189/2	189/2	0.42	arë	shtet
6			K-34-114-(153-B)	189/6	189/6	23.74	arë	shtet
7			K-34-114-(153-D)	196/4	196/4	0.2	arë	shtet
8			K-34-114-(153-D)	196/2	196/2	0.12	arë	shtet
9			K-34-114-(153-D)	196/9	196/9	1.54	arë	shtet
10			K-34-114-(153-B)	196/11	196/11	5.96	arë	shtet
11			K-34-114-(153-D)	198/3	198/3	1.6	arë	shtet
12			K-34-114-(153-D)	199	199	1.25	arë	shtet
13			K-34-114-(153-D)	226/1	226/1	1.90	arë	shtet
14			K-34-114-(153-D)	226/2	226/2	0.58	arë	shtet
Shuma						53.36		
1	Grabovicë	1832	K-34-114-(136-B)	10/77	10/77	2.00	pemëtores	shtet
2			K-34-114-(120-D)	226/10	226/10	15.82	arë	shtet
3			K-34-114-(136-B)	227/15	227/15	25.80	arë	shtet
4			K-34-114-(120-C)	237/39	237/39	4.28	arë	shtet
5			K-34-114-(136-B)	247/71	247/71	3.25	pemëtores	shtet
6			K-34-114-(136-A)	268	268	5.89	pemëtores	shtet
7			K-34-114-(136-A)	269	269	0.23	arë	shtet
8			K-34-114-(136-A)	280/17	280/17	10.14	arë	shtet
9			K-34-114-(120-C)	284/18	284/18	7.00	arë	shtet
10			K-34-114-(120-C)	319/12	319/12	2.82	arë	shtet
Shuma						77.23		
1	Leshnicë	2420	K-34-114-(119-B)	171/2	171/2	1.4	arë	shtet
2			K-34-114-(119-B)	175	175	0.2	arë	shtet
3			K-34-114-(119-C)	307	307	1.43	arë	shtet
4			K-34-114-(119-C)	340	340	0.15	arë	shtet
5			K-34-114-(119-C)	341	341	0.8	arë	shtet
6			K-34-114-(119-C)	342	342	0.83	arë	shtet
7			K-34-114-(119-C)	343	343	0.06	arë	shtet
8			K-34-114-(119-C)	345	345	0.82	arë	shtet
9			K-34-114-(119-C)	346	346	0.35	arë	shtet
			K-34-114-(119-C)	347	347	0.18	arë	shtet
Shuma						6.22		
	Lumas	2524	K-34-114-(104-B)	452	452	6.08	pemëtores	shtet
Shuma						6.08		
	Çerravë TOTAL					428.58		

SHUMA TOTALE						926.55		
--------------	--	--	--	--	--	--------	--	--

**VENDIM****Nr. 996, datë 9.12.2015****PËR KRITERET E BASHKËFINANCIMIT
TË PROJEKTEVE APO SHËRBIMEVE TË
KUJDESIT PALIATIV, NË RASTIN E
MARRËVESHJEVE TË LIDHURA
NDËRMJET MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE ORGANIZATAVE
JOFITIMPRURËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 25, pika 3, të ligjit nr. 138/2014, “Për kujdesin paliativ në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**1. Dispozita të përgjithshme**

Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (Fondi), financoi shërbimin e kujdesit paliativ, të ofruar nga organizatat jofitimprurëse (OJF), në bazë të marrëveshjeve të lidhura paraprakisht.

2. Kriteret që duhet të plotësojnë OJF-të, për të siguruar financimin e kujdesit paliativ nga Fondi, janë:

a) Statuti i OJF-së duhet të përputhet me parimet e ofrimit të kujdesit paliativ, sipas ligjit nr. 138/2014, “Për kujdesin paliativ në Republikën e Shqipërisë”;

b) Të jetë e licencuar për ofrimin e shërbimeve mjekësore, sipas legjislacionit në fuqi për autorizimet, licencat dhe lejet në Republikën e Shqipërisë;

c) Të disponojë kapacitete njerëzore/materiale të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve, për të cilat kërkohet bashkëfinancim, të cilat janë:

i) Hospis në banesë;

ii) Hospis ditor;

iii) Hospis me shtretër;

iv) Shërbime në institucione spitalore.

ç) Të ofrojë shërbime në zona të pambuluara me shërbime të kujdesit paliativ nga institucionet shëndetësore publike;

d) Të ketë, të paktën, pesë vite përvojë në ofrimin e shërbimeve në kujdesin paliativ;

dh) Të njihet me paketat përkatëse të shërbimit, që financohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, të hartuara dhe miratuara sipas legjislacionit në fuqi për sigurimin e

detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, dhe të deklarojë se i pranon ato;

e) Të deklarojë se shërbimet e kujdesit paliativ i ofron falas ose me çmim më të ulët se vlera e tregut;

ë) Të deklarojë se të ardhurat nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve mbulojnë, minimalisht, jo më shumë se 50 për qind të kostos së ofrimit të mallit/shërbimit dhe pjesa tjetër duhet të mbulohet nga donacionet, kontributet dhe të ardhura të tjera të OJF-së.

3. Ministria e Shëndetësisë, përpara se të vendosë bashkëfinancimin me OJF-të, duhet të:

a) identifikojë shërbimet e munguara të kujdesit paliativ, në tipologji dhe shpërndarje gjeografike;

b) hartojë udhëzues për referimin e shërbimit nga strukturat publike shëndetësore tek ato të ofruara nga OJF-të;

c) propozojë, në Këshillin e Ministrave, miratimin e paketave të shërbimeve, të hartuara dhe të kostuara nga Fondi;

ç) angazhojë shërbimin e urgjencës mjekësore për bashkëpunimin me OJF-të që do të bashëfinancohen;

d) sigurojë angazhimin e personelit të QSH-së gjatë ofrimit të kujdesit paliativ nga OJF-ja.

4. Procedura

a) Organizatat jofitimprurëse, të interesuara për të lidhur marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë, duhet të paraqesin, pranë saj, një kërkesë me shkrim, së bashku me dokumentet e mëposhtme:

i) Certifikatën tatimore, NIPT-in (fotokopje të noterizuar);

ii) Vendimin e gjykatës (fotokopje të noterizuar);

iii) Statutin e organizatës jofitimprurëse dhe kontratën e themelimit (për personat juridikë);

iv) Dokumentet nga gjykata, prokuroria, si për shoqatën edhe për administratorin, dëshminë për mosndjekje penale, nga Ministria e Drejtësisë;

v) Vërtetimin, nga zyra e përmbartimit, se ndaj subjektit nuk ka nisur procedurë falimentimi;

vi) Një deklaratë se mallrat apo shërbimet ofrohen falas apo, të paktën, 50 për qind më lirë se vlera e tyre në treg;

vii) Deklaratat financiare, të cilat duhet të përmbajnë:

- bilancin e tri viteve të fundit, vërtetuar nga eksperti kontabël i OJF-së;

- burimet e financimit.



b) Pas verifikimit të dokumentacionit, ministri i Shëndetësisë ngre, me urdhër, një komision për vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga OJF-të. Komisioni i vlerësimit të dokumentacionit, pas shqyrtimit të tyre, i paraqet ministrit të Shëndetësisë, për miratim, OJF-në/të që plotëson/jnë kushtet për të lidhur marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë. Ministri i Shëndetësisë fton OJF-në/të fituese për të lidhur marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve.

c) Marrëveshja tip e bashkëfinancimit të OJF-ve që ofrojnë kujdes paliativ kalon, për miratim paraprak, në Këshillin Administrativ të Fondit dhe miratohet me urdhër të ministrit të Shëndetësisë.

ç) Marrëveshja e bashkëfinancimit firmoset nga ministri i Shëndetësisë, ose një përfaqësues i autorizuar prej tij, dhe përfaqësuesi i OJF-së së shpallur fituese.

d) Marrëveshja e firmosur i kalon Fondit për zbatim.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për monitorimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 998, datë 9.12.2015

**PËRSHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI DHE
ASFALTIMI I RRUGËS NR. 5, LOTI 2 DHE
3, SARANDË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës nr. 5, loti 2 dhe 3, Sarandë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Sarandë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 55 638 387 (pesëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Urban për vitin 2015.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Sarandë.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Sarandë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë dhe Bashkia Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**TABELA E PASURIVEQËSHPRONËSOHENQËPREKENNGAZBATIMI I PROJEKTIT
"NDËRTIMI I RRUGËSTË 5-TË, LOTI II DHE III, SARANDË"**

Nr	Pronari		Zona kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji i ndërtimit	Sipërfaqja		Çmimi		Vlera		Shenime
	Emri	Mbiemri				Truall m ²	Ndërtim m ²	Truall lekë	Ndërtim lekë	Truall lekë	Ndërtim lekë	
1	RUSTEM	SHIHAI	8642 L.3	11/168	Banese	309	398	10777	82395	3330093	29136719	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	LEVENT	ÇATO	8642 L.3	11/134	Banese	151	43	10777	situacion	1626680	324054	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	AGRON	KASO	8642 L.3	16/304	Banese	70	27.5	10777	82395	754390	2265863	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	GEZIM	ISUFI	8641 L.4	1/123	Truall	90	0	10777	0	969930	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	KOZMA	QURKU	8642 L.4	2/99,2/100,2/101	Truall	597	0	10777	0	6433869	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	MAZAR	ISUFI	8642 L.4	7/36	Truall	23.8	0	10777	0	256493	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	SHPEITIM	CATO	8642 L.3	11/77	Truall	65	0	10777	0	700505	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	MERTIR	GJONI	8642 L.3	11/104	Truall	5	0	10777	0	53885	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	ANASTAS	PETKO	8641 L.3	19/141	Truall	52	0	10777	0	560404	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	RUZHIDI	IBRAHIMI	8642 L.4	3/58	Banese+Truall	54	14	10777	82395	581958	1153530	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	JORGJI	MUKA	8642 L.4	5/197	Truall	335	0	10777	0	3610295	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	SHERIF	KASAJ	8641 L.4	3/87	Truall	110	0	10777	0	1185470	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	KOSTA	CHJ	8642 L.3	8/178	Truall	5	0	10777	0	53885	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	HAXHIEKO	PROI	8641 L.3	16/110	Truall	245	0	10777	0	2640365	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Shuma						2112	483			22,758,222	32,880,166	
						VLERA TOTALE					55,638,388	Lekë

Shënim. Çmimi për qytetin e Sarandës për banesat 82395 lekë/m² është marrë nga ZVRPP-ja Sarandë dhe për truallin 10777 leke /m² sipas vendimit të Këshillit të Ministrave.

**VENDIM
Nr. 999, datë 9.12.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT "REHABILITIMI I
SHËTITORES KRYESORE ANËS DETIT,
HIMARË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i shëtitores kryesore anës detit, Himarë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Himarë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "truall" dhe "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 43 906 145 (dyzet e tre milionë e nëntëqind e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e pesë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 43 906 145 (dyzet e tre milionë e nëntëqind e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e pesë) lekësh, si dhe shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Zhvillimit Urban për vitin 2015.

5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Himarë.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e



pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

TABELA E PRONAREVE TE SHPRONESIMIT PER INTERES PUBLIK TE PROJEKTI "REHABILITIMI I SHETITORES KRYESORE ANES DETIT, HIMARË"

Nr	Mbiemer	Emer	Lloji i pasurisë	Nr. Hipotekore/Pasurie	Zone Kadastrale	Sip. objektit qe Shpronsohet	Vlera e objektit per Shpronsimet ne Leke	Cmimi i objektit per njesi sipas titullit te shpronesis	Cmimi i tokes se objektit per njesi sipas VKM.nr.514	Vlera e tokes per Shpronsimet ne Leke	Vlera totale per shpronsimet - vlerë e objektit - vlerë e tokes ne proporcion me sip.	Vendodhje
1	Beno	Edmond	Objekt-biznes	2386	1952	684 m ²	20880047.2	Ky cmim eshte llogaritur me koef.amortizimi 11% qe nga viti 2004 pas rikonstruksionit			20880047.2	Spile,Himare
2	Gjicali	Fotaq	Objekt-banese	244	1952	176 m ²	7490736	42561 leke/m2	4350 leke/m2	765600	6725136	Spile,Himare
3	Doja	Ferdinant	Objekt-banese	459	1952	53.5 m ²	2277013.5	42561 leke/m2	4350 leke/m2	212477.92	2064535.58	Spile,Himare
4	Doja	Ferdinant	Objekt-banese	466	1952	37.8 m ²	1608805.8	42561 leke/m2	4350 leke/m2	184677.1	1424128.7	Spile,Himare
5	Gjoka	Jorgo	Objekt-banese	458	1952	152 m ²	6469272	42561 leke/m2	4350 leke/m2	346608	6122664	Spile,Himare
6	Gjoka	Kristo	Objekt-banese	457	1952	166 m ²	7065126	42561 leke/m2	4350 leke/m2	375492	6689634	Spile,Himare

SHUMA = 43906145.48



PREVENTIV PUNIMESH SIPAS EKB-se						
OBJEKTI: SPRONESIMI I OBJEKTIT Z. EDMOND BENO						
VENDODHJA: QYTETI I HIMARES, BASHKIA HIMARE						
Nr	Nr/ana	EMERTIMI I PUNIMEVE	Njes	Sasia	Cmimi	Vlera(leke)
2-Punime murature dhe betoni						
1	86	Mur me tulle me 8 vrima, t=12cm, h=3m, llaç perzier M15	m³	80	9,008.00	720,640.00
2	129/1	Mur betoni C 12/15	m³	190	15,218.00	2,891,420.00
3	117/1	Kollona b/a monolite C - 16/20	m³	120.8	17,116.00	2,067,955.12
4	122/1	Soleta b/a me polisterol C18/22.5	m³	180.8	15,604.00	2,820,891.12
5	109/1	Themel betoni C-12/15	m³	116.0	9,778.00	1,134,150.22
6	110/1	Themel buto betoni C-12/15	m³	95.9	8,685.00	832,891.50
7	114/1	Pllake themeli C-16/20	m³	85.2	9,104.00	775,660.80
Shuma 1						11,243,608.76
4-Punime shtresash						
1	362/2	Shtrese me pllaka majolike e dyshemese te brendshem,wc-ve.	m²	750	2,033.00	1,524,750.00
2	An	Shtrese me pllaka per ambjent te jashteme	m²	400	2,017.00	806,800.00
3	An	Veshje me rasa guri	m²	500.0	4,684.00	2,342,000.00
4	265	Shtrese pllaka qeramike me llac	m²	400	1,744.00	697,600.00
5	An	F.V. Kangjella metalike	m²	187	3,800.00	710,600.00
Shuma 2						6,081,750.00
5-Punime dyer-dritare						
1	An	F.V. dyer druri	m²	17.0	9,725.00	165,325.00
2	An	Dyer d/alumini dopio xham	m²	17.0	9,889.00	168,113.00
3	An	Vetrate xhami	m²	95	9,600.00	912,000.00
Shuma 3						1,245,438.00
6-Punime hidrosanitare						
1	502	F.V WC cilesi e II	cope	3	8,283.00	24,849.00
2	2.495	F.V lavaman cilesi e II	cope	3	7,993.00	23,979.00
Shuma 4						48,828.00
SHUMA 1 + SHUMA 2+ SHUMA 3+ SHUMA 4					18,619,624.76	
Punime Elektrike 5%					930,981.24	
SHUMA					19,550,606.00	
T.V.SH. 20%					3,910,121.20	
SHUMA TOTALE+T.V.SH. 20%					23,460,727.20	

VENDIM

Nr. 1000, datë 9.12.2015

PËRSHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS NGA MUZEU HISTORIK - SPITALI, VLORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008,”Për menaxhimin e

sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit,



“Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës nga Muzeu Historik - Spitali, Vlorë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtësë”, me vlerë totale të shpronësimit prej 18 146 972 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 18 146 972 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të paraqesin dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

Lista e objekteve që preken nga projekti: "Sistemim asfaltimi i rruges nga Muzeu Historik - Spitali Vlore".

Nr	Zona kadastrale	Nr. Pasurise	Adresa	Pronari	Siperfaqe Truallit	Siperfaqe ndertimit	Çmimi i Truallit Leke/m2	Çmimi i Ndertimit Leke/m2	Vlera e Truallit Leke	Vlera e Ndertimit Leke	Vlera truall dhe ndertese	Shenime sipas ZVRPP dhe dok. Te dorëzuar
1	8601	7/200	Vlore	Kozma Tata	114	56	7,002	14,808	798,228	829,220	1,627,448	Certifikate pronësie
2	8601	7/159	Vlore	Ardian Dauti	0	66	7,002	14,808	0	878,287	878,287	Certifikate pronësie është mbajtur vlera e truallit për ndërtimin jashtë vijes së shpronësimit
3	8601	7/101	Vlore	Liri Shehu	27.98	0	7,002		195,916	0	195,916	Certifikate pronësie
4	8601	7/124	Vlore	Aranit Ibrahimaj		21	7,002	14,808	0	310,958	310,958	Vendim gjykate
5	8601	7/122	Vlore	Fitim Veizaj	0	20	7,002	14,808	0	296,160	296,160	Certifikate pronësie
6	8601	4/1	Vlore	B.P. Xhemali	53.03	100	7,002		371,316	5,734,457	6,105,773	Certifikate pronësie është mbajtur vlera e truallit për ndërtimin jashtë vijes së shpronësimit
7	8601	3/25	Vlore	Mahmut Balleshi	33.96	0	7,002		237,788	0	237,788	Certifikate pronësie
8	8601	3/85	Vlore	Mahmut Balleshi	42.7	0	7,002		298,985	0	298,985	Certifikate pronësie
9	8601	3/124	Vlore	Wilson Balleshi, Petrit Ba	7.18	109.2	7,002		50,274	0	50,274	saktësim dok.për truallin/P.P.V
10	8601	2/176	Vlore	Pellumb Ymeraj	16.17	107	7,002		113,222	5,886,312	5,999,534	sak. dok.Certifikate pronësie
11	8601	2/175	Vlore	Enver Resuli	0	36	7,002	61,655	0	2,145,849	2,145,849	Vendim gjykate
18,146,972												

V.o: cmimi i truallit është marrë në V.K.M NR. 514 date 30.07. 2014

cmimi i nderteses sipas z.v.r.p.p.

cmimi objekt banimi sipas Udhezimit Nr. 2, date 06.08.2014

KRYEMINISTRI

Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë